

**NJOFTIM
PËR MBLEDHJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME
TË AKSIONERËVE TË "BANKA CREDINS" SH.A.**

Për: Z/Znj. _____ (Aksionar/Përfaqësues/e i/aksionarit _____)

Ju njoftojmë se ditën e Hënë datë 29 Maj 2023 ora 11:00 në ambientet e "BANKA CREDINS" SH.A., në adresën Rr. "Vaso Pasha" Nr. 8, Tiranë, do të zhvillohet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të "BANKA CREDINS" SH.A me rend dite si më poshtë:

1. Propozim për riemërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Banka Credins sh.a. Z. Maltin Korkuti.
2. Ngarkohet Drejtoria të kërkojë miratimin pranë Bankës së Shqipërisë, për riemërimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankes Credins sh.a. Z. Maltin Korkuti dhe të bëjë regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.
3. Propozim për marrjen në pronësi të kolateraleve të debitorëve të Bankës Credins si rezultat i procesit përmbarimor.
4. Mbi miratimin e ekspertës kontabël të autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksioner të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit të fitimit të pashpërndare të vitit 2022.
5. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive me rend dite si më poshtë:
 - 1) Mbi miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit të pavarur, të shoqërisë administruese Credins Invest sh.a., të Fondit të Pensionit "Credins Pension", të Fondit të Investimit "Credins Premium", të Fondit "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, të Fondit "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, për vitin e mbyllur më 31.12.2022.
 - 2) Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultetit për vitin e mbyllur më 31.12.2022.
 - 3) Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare:
 - të shoqërisë administruese "Credins Invest" sh.a.,
 - të fondit të pensionit "Credins Pension",
 - të fondit të investimit "Credins Premium",
 - të fondit "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK,
 - të fondit "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK.për vitin financiar që mbyllet me 31.12.2023.
 - 4) Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 - 5) Mbi miratimin e riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., – Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, për periudhën 3-vjeçare nga data 24.07.2023 deri në datën 24.07.2026, konkretisht:
 - Znj. Estela Koci
 - Znj. Vjosa Bodo (Mujo)

- Z. Eugen Nuri

6. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK qe eshte zhvilluar me rend dite sa me poshtë:
 1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese (ekspert kontabël i miratuar).
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2022.
 3. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.
 4. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 5. Paraqitjen per dijeni te raportit vjetor te risqeve
7. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti ne mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, qe eshte zhvilluar me rend dite sa me poshtë:
 1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi të paraqitur nga shoqëria e përzgjedhur audituese (ekspert kontabël i miratuar).
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit të vitit ushtrimor 2022.
 3. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.
 4. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 5. Paraqitjen per dijeni te raportit vjetor te risqeve
8. Ngarkohet Drejtoria të bëjë njoftimet, të kërkojë miratimet kur është rasti dhe të bëjë regjistrimet përkatëse në përputhje me Ligjin.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë më 08.05.2023

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionarët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»
- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

- b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumenteve dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.